

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Autori me dy armë në duar, ja momenti i ekzekutimit të Artan Myrtajt në Sarandë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/autori-me-dy-arme-ne-duar-ja-momenti-i-ekzekutimit-te-artan-myrtajt-ne-s-i588323
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 12:23:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 12:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	788f7d839d7369e46e2249a6a757cb5bbacd5172d01e51836dfefb2f4a2f0cbe6
TEKSTI	c948651dee0ec9aace3438c79823eacef10073e73e3ce0d827898516cf13b0b1
PAMJA	1b0fe4f77991a5abccfa6280155486e096e06ab0609eaffdfac5dff84275c006

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6e1caa3c012323dbaad25601788a4b93a73cc4526033b7b3c3495fe5b43fad7c
E MËPARSHMJA	1bf5711fb411d9f458f0d4b376d01dae75aed9a6b987888c27dd48d58e22a78f
RRËNJA MERKLE	a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6e1caa3c012323dbaad25601788a4b93a73cc4526033b7b3c3495fe5b43fad7c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by  [Kontakt](#)



 [English](#)



le Projektigji i PDK per "Hagen" dergohet te KurtiBlendi Gonxhe: Ne Butrint po punohet çdo dite per te ruajtur trashegimin e Lazari fundit

"Kudo qe shkoj ka shqiptare qe me r

VIDEO/ Autori me dy armë në duar, ja momenti i ekzekutimit të Artan Myrtajt në Sarandë

TemA

25 Shtator 2026, 14:17Kronika TEMA



Klan News ka siguruar fotot ekskluzive të autorëve të vrasjes së 44-vjeçarit Artan Myrtaj pak ditë më parë në Sarandë.

Ky që shihni në këtë pamje është autori, i cili mban dy armë dhe është i veshur me një xhup në ngjyrë jeshile, pantallona të zeza dhe me skafandër në kokë.

Fotoja është shkëputur nga kamerat e sigurisë. Fillimisht, autori ka qëlluar me pistoletën me silenciator dhe, pasi i është bllokuar, ka qëlluar me pistoletën tjetër që e mban në dorën e djathtë.

Në foton tjetër është drejtuesi i motorit me targa greke, i cili ka ndihmuar autorin për t'u larguar.

Pas ekzekutimit, sipas të dhënave të siguruara nga grupi hetimor, autorët kanë shkuar drejt Konispolit, teksa nuk përjashtohet mundësia që të jenë arratisur ilegalisht drejt Greqisë.

Artan Myrtaj u vra paraditen e së dielës, më 20 shtator, në zonën e njohur si ish-Agjencia, në qytetin e Sarandës, ku, krahas tij, u plagos edhe një 73-vjeçar.

Ekzekutimi i tij dyshohet se lidhet me një sërë ngjarjesh të regjistruara në Sarandë, që zanafillën e kanë në një plagosje të regjistruar në korrik të vitit 2025. Myrtaj rezultoi të ketë qenë pjesë e atij konflikti, ndaj dhe hetuesit janë përqendruar te kjo pistë hetimi.

Për zbulimin e autorëve, policia ka pyetur mbi 30 persona, por ende nuk ka rënë në gjurmët e tyre.

Pas ngjarjes, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skënder Hita, ngriti një grup të posaçëm hetimor për të verifikuar situatën kriminale në qytetin e Sarandës.

Me firmën e kryepolicit, u zëvendësua shefi i Komisarariatit, Feliks Hodo, i cili u transferua në Dibër. Ndërsa Komisarati i Policisë së Sarandës do të drejtohet në vijim nga Saimir Shkambaj.



3 Komente

R

Realisti

25 Shtator 2026, 14:23

Bo bo bo... çfarë bëhet. Po mirë o polici e leshit. Asnjë policë nuk gjendej në rrugët tona në qytet apo në hyrje të Sarandës?

↩ Përgjigjuni

👍 2 🗳️ 1 ❤️ 0

M

Me shprese mbase Drejtësia zgjohet...

25 Shtator 2026, 15:18

Ka qe mbas 1997 qe njerezit vriten me Armer e Depove ! Ata qe urdhera hapjen e Depove te Armeve, e realizuan Spunazhin mbi zhdukjen e popullsisist duke u vrare beri me tjetrin... Ndersa Penecilina me miqte e tije , Reciton ne Kuvendin e Shqiperise per Drejttesi.... Mbase ky amerikani Ushtarak qe ka zbrutur ne toten shqiptare ! Mbase jepe ndonje shprese qe Drejtesia te Arestoje njerezit kryesore Kriminele... Se vete si Drejttesi skane kellqe te Arestojne. .

↩ Përgjigjuni

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

M

Me shprese mbase Drejtësia zgjohet...

25 Shtator 2026, 15:18

Ka qe mbas 1997 qe njerezit vriten me Armer e Depove ! Ata qe urdhera hapjen e Depove te Armeve, e realizuan Spunazhin mbi zhdukjen e popullsisist duke u vrare beri me tjetrin... Ndersa Penecilina me miqte e tije , Reciton ne Kuvendin e Shqiperise per Drejttesi.... Mbase ky amerikani

Ushtarak qe ka zbrutur ne toten shqiptare ! Mbase jepe ndonje shprese qe Drejtesia te Arestoje njerezit kryesore Kriminele... Se vete si Drejtesi skane kellqe te Arestojne. .

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

💬 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Përplasja për pagat, Sadushi: Vendimet e Kushtetueses të panegociueshme

12:00 Kronika / 21 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.